

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Banka JET/ Qarkullon paratë e Forex? Si u trash kapitali nga 3 mln lekë në 26 milionë €! Ndryshoi emrin dhe manovra mes bosëve izraelit Louis Grant Silver e Idan Avishai
ADRESA	https://shqip.com/banka-jet-qarkullon-parate-e-forex-si-u-trash-kapitali-nga-3-mln-leke-ne-26-milione-e-ndryshoi-emrin-dhe-manovra-mes-boseve-izraelit-louis-grant-silver-e-idan-avishai/
BURIMI	shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:15:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:01:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	79ded2b9b27e651197c5cf9607d4eb5687592f6dc34ff7a9d8131c8163f259f4
TEKSTI	4f2f05c8b8e40254ec6c27919acdc374a9b0c68431615f784298b0dd231f7a7e
PAMJA	610802370fa71449a6668075a249d4bae4c9ab8a8cdf835871ed8576654c0536

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1c2af5f31b98c8fbc449bc3189ba79278ef15981ee65788d7b7768ebfabbe0f6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1c2af5f31b98c8fbc449bc3189ba79278ef15981ee65788d7b7768ebfabbe0f6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lajme

Banka JET/ Qarkullon paratë e Forex? Si u trash kapitali nga 3 mln lekë në 26 milionë €! Ndryshoi emrin dhe manovra mes bosëve izraelit Louis Grant Silver e Idan Avishai



Publikuar: (17.09.2026 22:01:14)



Share



Nga një shoqëri me kapital fillestar prej 3.5 milionë lekësh, te një bankë me kapital 2.46 miliardë lekë brenda pak muajsh. Ndërkohë, pronësia kalon te një holding holandez, por në regjistrin e pronarëve përfutues Idan Avishai vijon të figurojë si kontrollues i 71.52% të kapitalit. Në strukturën e re shfaqen kompani nga Qiproja, Izraeli dhe Holanda, ndërsa disa prej emrave të lidhur me bankën kanë një histori të dokumentuar në aktivitetin Forex.

Historia e Banka Jet nis me shoqërinë "JET ALBANIA", e cila kishte si ortak të vetëm dhe administrator Idan Avishai.

Më 31 korrik 2025, me vendim të asamblesë së ortakut të vetëm, Avishai u largua nga detyra e administratorit dhe në vend të tij u emërua Fatbardha Rino.

Por largimi i tij nga administrimi nuk do të nënkuptonte shpëputjen nga struktura e pronësisë. Sipas të dhënave të Regjistrat të Pronarëve Përfutues të depozituara në QKB, Avishai do të vijonte të figurojë më pas si pronar përfutues i një pjese dërrmuese të kapitalit të bankës.

Janar 2026: JET Albania bëhet Banka Jet

Më 19 janar 2026, me vendim të asamblesë së aksionarit të vetëm, emri i subjektit ndryshoi nga "JET ALBANIA" në "Banka Jet".

Po atë datë u shtua edhe emri tregtar "Jet Bank".

Ndryshimi i emrit shënoi një tjetër fazë të projektit, ndërsa në të njëjtën periudhë ndryshuan edhe strukturat drejtuese.

Në këshillin mbikëqyrës u shtuan Philippe Edgar Meyer, Robert Ryan Rudolph, Fatbardha

TË FUNDIT

N'SHËNJESTËR



Bardhi: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Lajme



"Botoxi" kontrabandë, Dritan Gremi i "Gremi Wellness" përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdis Faria i "Kelt"

Lajme



Iute Credit zhvat shqiptarët me interesat e larta të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transferon miliona euro në Estoni

Lajme



Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i "Gremi Wellness" dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal

Lajme



Samir Mane ujdj me SPAK/ Biznesmeni mbërriti në Prokurori pas orarit zyrtar për të shmangur mediat

Lajme



Anëtarja e Rithemelimit të PD: Ja si Berisha mashtrroi me vizitën në SHBA

Lajme



Për çfarë u dënuan Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Rexhep Selimi?

Lajme



Samir Mane merret në pyetje nga SPAK. Biznesmeni paraqitet në Prokurorinë e Posaçme jashtë orarit zyrtar (VIDEO)

Lajme



Vendimi i Hagës për kërret e UÇK-së Elisa Spiropali: Po dënohet lufta çlirimtare, Kuvendi i Shqipërisë e Kosovës të miratojnë rezolute të përbashkët

Lajme



Haga shqipton vendimet: Thaçi dhe Krasniqi dënohen me nga 25 vite burg, 18 për Kadri Veselin dhe 13 për Rexhep Selimin

Ballkan

Rino, Aigest Milo dhe Alketa Emini, me datë fillimi të funksioneve 19 janar 2026.

Në regjistrimet e mëvonshme pasqyrohet largimi nga këshilli i administrimit i Robert Ryan Rudolph, Alketa Emini, Fatbardha Rino dhe Philippe Edgar Meyer.

26 janar 2026: ndryshon pronari direkt

Një ditë pas ndryshimit të emrit tregtar dhe ligjor, ndodhi një tjetër lëvizje e rëndësishme në strukturën e pronësisë.

Sipas kontratës së shitblerjes së kuotave, të datës 26 janar 2026, Idan Avishai shiti 100% të kuotave që zotëronte në favor të shoqërisë Jet Holdings B.V.

Çmimi i shitjes ishte 972 mijë lekë.

Transaksioni u pasqyrua në QKB më 27 janar 2026. Avishai u largua si ortak dhe Jet Holdings B.V. u bë ortak i vetëm, me 100% të kuotave.

Në pamje të parë, kjo do të nënkuptonte largimin e Avishait nga pronësia direkte. Por dokumentet mbi pronësinë përfituese japin një tjetër tablo.

Avishai vijon të figurojë si pronar përfitues i 71.52%

Sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit të Pronarëve Përfitues, të depozituar në QKB më 16 shkurt 2026 dhe të tërhequr më 10 shtator 2026, Idan Avishai, shtetas anglez, rezulton pronar përfitues i 71.52% të kapitalit të Banka Jet.

Sipas këtij dokumentacioni, kontrolli ushtrohet përmes një zinxhiri shoqërisht.

Avishai zotëron 100% të Constador LTD, shoqëri e regjistruar në Qipro me NIPT HE 478734.

Constador LTD zotëron 71.52% të Jet Holdings B.V.

Ndërkohë, Jet Holdings B.V. zotëron 100% të Banka Jet.

Jet Holdings B.V. është shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit holandez, me seli në 's-Gravenhage dhe me numër regjistrimi 98334050.

Në regjistrin e pronarëve përfitues, data e përcaktimit të Idan Avishait si pronar përfitues është 8 korrik 2025.

Pra, ndërsa në janar 2026 Avishai largohet formalisht si ortak direkt i shoqërisë shqiptare, në regjistrin e pronarëve përfitues ai vijon të figurojë si kontrollues përfitues i 71.52% të Banka Jet përmes strukturës Constador LTD–Jet Holdings B.V.

Gjashtë kompani pas Jet Holdings

Struktura e Jet Holdings nuk përbëhet vetëm nga Constador LTD.

Sipas dokumentacionit të depozituar, Jet Holdings ka gjashtë shoqëri aksionare:

Constador LTD, e regjistruar në Qipro – rreth 71.5%;

Don Albania Holdings LTD, e regjistruar në Izrael – 3.7%;

Ori Eyal LTD, e regjistruar në Izrael – 2.6%;

Yebogogo LTD, e regjistruar në Izrael – 4.9%;

Nathan Lawrence LTD, e regjistruar në Izrael – 4.9%;

Israel Albania Holding LTD, e regjistruar në Izrael – 12.4%.

Kështu, pas aksionarit direkt, një shoqëri holandeze, shfaqet një strukturë e përbërë nga kompani të regjistruara në Qipro dhe Izrael, ndërsa pjesa kryesore e kontrollit lidhet me Constador LTD.

Nga 3.5 milionë në 2.46 miliardë lekë kapital

Një nga ndryshimet më të forta të Banka Jet gjatë vitit 2026 është rritja e kapitalit.

Kapitali themelues i shoqërisë ishte 3.5 milionë lekë. Por brenda pak muajsh kapitali u rrit disa herë.

Më 23 shkurt 2026, me vendim të aksionarit të vetëm, u miratua zmadhimi i kapitalit me 1.056 miliardë lekë, përmes kontributit në para të aksionarit të vetëm. Pas kësaj rritjeje, kapitali arriti në 1.0595 miliardë lekë.

Më 16 prill 2026, u miratua një tjetër rritje, prej 136.731 milionë lekësh, këtë herë përmes kapitalizimit të huasë, të konvertuar në lekë. Kapitali arriti në 1.196231 miliardë lekë.

Vetëm pak ditë më pas, më 22 prill 2026, u miratua një tjetër rritje, prej 382.040 milionë lekësh, përmes kontributit në para të aksionarit të vetëm. Kapitali arriti në 1.578271 miliardë lekë.

Më 5 qershor 2026, kapitalit iu shtuan edhe 336.015 milionë lekë, përmes kontributit në mjete likuide të aksionarit të vetëm. Kapitali u bë 1.914286 miliardë lekë.

Dhe më 25 gusht 2026, u miratua rritja e radhës, prej 551.1 milionë lekësh, sërish përmes

kontributit të aksionarit të vetëm në mjete likuide.Pas kësaj rritjeje, kapitali i Banka Jet arriti në:

2.465386 miliardë lekë.

Pra, nga kapitali fillestar prej 3.5 milionë lekësh, shoqëria kaloi në një kapital prej rreth 2.46 miliardë lekësh, përmes pesë rritjeve të njëpasnjëshme gjatë vitit 2026.

Emrat pas bankës dhe lidhjet me Forex

Një tjetër element që bie në sy në këtë strukturë janë lidhjet profesionale të disa prej personave të përfshirë me aktivitetin Forex.

Louis Grant Silver, drejtor i Constador LTD, rezulton se ka një karrierë në investimet në valutë të huaja, të njohura si Forex.

Sipas materialeve të disponuara, Silver shërben ende si drejtues aktiv në Fortrade Limited, kompani që operon në këtë aktivitet.

Po ashtu, ortak i tij Oliver Hemmer rezulton drejtues i Fortrade Cyprus, filiali qipriot i Fortrade.

Në këtë panoramë përfshihet edhe Idan Avishai, i cili, përveçse rezulton ende pronar përfitues i 71.52% të Banka Jet sipas regjistratit shqiptar, paraqitet i lidhur me Fortrade dhe me një eksperiencë të gjatë në aktivitetin Forex.

Këto lidhje janë veçanërisht të rëndësishme për t’u evidentuar për shkak të rolit që këta persona kanë ose kanë pasur në strukturat e lidhura me Banka Jet.

Një ndryshim formal, por pronësia përfituese mbetet në të njëjtat duar

Kronologjia e zhvillimeve tregon një transformim të shpejtë. Në korrik 2025, Idan Avishai largohet si administrator. Në janar 2026, shoqëria ndryshon emrin nga JET ALBANIA në Banka Jet, ndërsa shton emrin tregtar Jet Bank. Pak ditë më vonë, Avishai shet 100% të kuotave të Jet Holdings B.V. Por dokumenti i pronarëve përfitues i depozituar në QKB në shkurt dhe i tërhequr në shtator 2026 e identifikon sërish Avishain si pronar përfitues të 71.52% të Banka Jet, përmes Constador LTD dhe Jet Holdings B.V. Ndërkohë, kapitali i bankës rritet nga 3.5 milionë lekë në 2.465 miliardë lekë, ndërsa në strukturën e saj shfaqen kompani nga Holanda, Qiproja dhe Izraeli.

Dhe mbi këtë strukturë, një tjetër pikë që kërkon vëmendje janë lidhjet e disa prej personave kryesorë me industrinë Forex, ku përfshihen emra si Louis Grant Silver, Oliver Hemmer dhe Idan Avishai. Në këtë kuptim, historia e Banka Jet nuk është thjesht historia e një ndryshimi emri. Brenda pak muajsh kemi një ndryshim të pronarit direkt, një strukturë të re ndërkombëtare të pronësisë, ndryshime në organet drejtuese dhe një rritje të jashtëzakonshme të kapitalit, ndërsa pronësia përfituese e pjesës kryesore të bankës vijon të lidhet, sipas dokumenteve të depozituara, me Idan Avishain. Kjo strukturë ngre pikëpyetje legjitime për transparencën e pronësisë, origjinën dhe mënyrën e injektimit të kapitalit, si dhe për marrëdhëniet e personave që qëndrojnë pas bankës me aktivitetin Forex. Pikërisht këto elemente e bëjnë të nevojshme që struktura e kontrollit dhe historiku i saj të shihen përtej ndryshimeve thjesht formale në regjistrat e kompanive.

/Shqip.com

N'SHËNJESTËR

Kurti takoi “fshehtas” politikanin kontravers serb, Boban Bogdanoviq

Blerja e tri çantave, shkakton përplasje në Institutin e Avokatit të Popullit

Inspektimi zhvesh dyqanin e arit

Limak sërish mbi shtetin

TË NGJASHME

Bardhi: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

“Botoxi” kontrabandë, Dritan Gremi i “Gremi Wellness” përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skënder Faria i “Këit”

Iute Credit zhvat shqiptarët me interesat e larta të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transferon miliona euro në Gëtor

Merret i pandetuar Dritan Gremi, pronar i “Gremi Wellness” dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe quajon fidejal

Samir Mane ujdj me SPAK/ Biznesmeni mbërriti në Prokurori pas orarit zyrtar për të shmanjur mediat

Të fundit nga Lajme

Bardhi: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Publikuar:

“Botoxi” kontrabandë, Dritan Gremi i “Gremi Wellness” përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdi Faria i “Keit”

Publikuar:

Iute Credit zhvat shqiptarët me interesat e larta të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transferon miliona euro në Estoni

Publikuar:

Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i “Gremi Wellness” dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal

Publikuar:

Samir Mane ujdj me SPAK/ Biznesmeni mbërriti në Prokurori pas orarit zyrtar për të shmangur mediat

Publikuar:

Anëtarja e Rithemelimit të PD: Ja si Berisha mashtroi me vizitën në SHBA

Publikuar:

Për çfarë u dënuan Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Rexhep Selimi?

Publikuar:

Samir Mane merret në pyetje nga SPAK. Biznesmeni paraqitet në Prokurorinë e Posaçme jashtë orarit zyrtar (VIDEO)

Publikuar:

Të fundit nga Rubrikat

Dhuna ndaj Eduard Kuçit, Gjykata jep vendimin për Jozin

Publikuar:

OBP në workshop-in ndërkombëtar të BERZH, Shqipëria drejt prokurimit të gjelbër dhe social

Publikuar:

Kompozitori dhe DJ Rinor Kastrati, në bashkëpunim me MP3.ofc dhe James Hersey, publikojnë këngën e re “Miss You”

Publikuar:

Bardhi: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Publikuar:

Dhjetë ditë në shesh, një thirrje për të gjithë politikën: Mjaft më!

Publikuar:

Flet Ziza Pajazitit: Si hyra 2 herë në burg për takim me Haxhiun. E kam bashkëjetues, bëmë takim familjar

Publikuar:

Skandal në Champions League! Tifozët serbë shfaqin sérish banerin “Kosovo is Serbia”

Publikuar:

Dua Lipa padit Samsung, kërkon 15 mln dollarë dëmshpërblim

Publikuar:

Të fundit në Shqip.com

Bardhi: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Publikuar:

“Botoxi” kontrabandë, Dritan Gremi i “Gremi Wellness” përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdi Faria i “Keit”

Publikuar:

Iute Credit zhvat shqiptarët me interesat e larta të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transferon miliona euro në Estoni

Publikuar:

Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i “Gremi Wellness” dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal

Publikuar:

Samir Mane ujdj me SPAK/ Biznesmeni mbërriti në Prokurori pas orarit zyrtar për të shmangur mediat

Publikuar:

Anëtarja e Rithemelimit të PD: Ja si Berisha mashtroi me vizitën në SHBA

Publikuar:

Për çfarë u dënuan Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Rexhep Selimi?

Publikuar:

Samir Mane merret në pyetje nga SPAK. Biznesmeni paraqitet në Prokurorinë e Posaçme jashtë orarit zyrtar (VIDEO)

Publikuar:

Lajme

Sport

Rozë

Kulturë

Art Jetese

Ekonomi

Teknologji

OP-ED

Balkan

Ndërkombëtar

Ndërkombëtar

Kino

Horoskopi

Biznes

Auto

Analiza

Botë

Shqiptar

Shqiptar

Libra

Moda

Marketing

Shkencë

Editoriale

Gjykata Speciale

Muzikë

Shëndeti

Tregjet

Kolumne

Shqiptare

Ushqime



Albmedia
1000 Tirane - Albmedia

Marketing:

Rreth Shqip.com

Etika Redaktoriale

Reklamat dhe të ardhurat

Privacy Policy

